




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South


Kryetari i Komunës

Nr. 01.400/04 - UJ 37145 - 2 / dt. 02.07.2026
Mitrovicë / 16

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, Rregulloren Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve dhe pas shqyrtimit të Propozim-Vendimit të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Nr. 01-400/04-0037145/26, të datës 30.06.2026, Kryetari i Komunës sjell këtë:

V E N D I M

1. **Aprovohet** Propozim-Vendimi i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural Nr. 01-400/04-0037145/26, të datës 30.06.2026, dhe i lejohej shfrytëzimi i mjeteve financiare nga buxheti i Komunës së Mitrovicës, në shumë prej 57,227.20 € (pesë dhjetë e shtatë mijë e dyqind e njëzet e shtatë Euro e njëzet Cent), për realizimin e projektit me titull: “Subvencionimi i Fermerëve me Mekanizma Bujqësor” për vitin 2026.
2. Mjetet e lejuara sipas pikës 1 të këtij Vendimi do të shfrytëzohen për realizimin e projektit të parapara me planin e punës së Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
3. Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural obligohet që të zhvillojë procedurat për ndarjen e subvencioneve në harmoni me Rregulloren Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve si dhe dispozitave tjera ligjore dhe nënligjore nga fusha përkatëse.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, ndërsa mjetet e parapara sipas këtij vendimi paguhen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe Transfere të Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Shtojcë:

Propozim-vendimi i DBZHR-së Nr. Nr. 01-400/04-0037145/26, të datës 30.06.2026.

Ti dorëzohet:

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
- 1x1 Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

